REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

Datë 20.08.2026 Prot.58 (pesëdhejtëetetë)

Protokoll nr. 58

I mbajtur sot më datë 20.08.2026, në mbledhjen jashtë radhe të Këshillit Bashkiak Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite:

1.Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës,);

2.Miratimi i mendimit zyrtar të Këshillit Bashkiak Maliq dhe përcjellja e tij pranë Kuvendit të Republikës të Shqipërisë, në kuadër të procesit të rishikimit të ndarjes administrativo-territoriale.Ku bashkia Maliq propozohet të bashkohet me bashkinë Korçë.

Këshilltarë të pranishëm në sallë:

Ornildi Demollari; Pranvera Begolli; Klea Baçi; Petrit Kupe; Marinathi Avrami; Dritan Çami; Idlir Limllari; Selami Muço; Fevri Sherifi; Krisitna Malelli; Dalina Krekas;Yllson Ibrahimllari; Neresida Shindo; Lulëzim Hoxhaj; Server Xhuti; Faslli Zholi; Andonaq Risto; Eglantina Balli; Almir Elezi; Marjeta Xhelollari; Albina Xhejo erdhi 10:30; 21(njëzetëenjë) këshilltarë.

Mungesa: Xhuana Hoxhallari; Rovena Terolli; Floreta Zaçe;Aramando Dautllari; Eriseld Jonusllari; Enida Avdolli; Gentiana Drabo; Danjela Ibrahim; Plator Çollaku; Ilia Xhuti; 10 (dhjetë).

Të pranishëm nga Administrata:

Ornildi Demollari: Mirë. Të nderuar kolegë këshilltarë, të nderuar pjesëmarrës, mirëdita të gjithëve. Mirëdita të gjithëve në këtë mbledhje jashtë radhët të Këshillit Bashkiak të Bashkisë tonë, Bashkisë Maliqit. Së pari, verifikojmë korumin; bëjmë një verifikim të korumit dhe, me sa shikoj, korumi realizohet, pasi në sallë janë 19, apo 20 këshilltarë, në 31, që do të thotë se korumi realizohet dhe mund të vijojmë me mbledhjen. Sikurse e theksova, kjo është një mbledhje jashtë radhe e Këshillit Bashkiak, e thirrur posaçërisht për një çështje të vetme, që është çështja e reformës administrative territoriale, nga e cila preket edhe bashkia jonë. Kjo mbledhje është thirrur me një nismë të grupit të këshilltarëve të opozitës, të cilët i falënderoj për këtë pjesë, ku me 1/3-ën, ku nisma e tyre përbën 1/3-në e anëtarëve të Këshillit Bashkiak, dhe

mbi bazën e kësaj thirrjeje është po zhvillohet edhe kjo mbledhje jashtë radhe. Tani, ju ftoj të miratojmë rendin e ditës njëherë, si fillim.
Kush është dakord me rendin e ditës? 19 vota pro.
Kundër? Nuk ka?
Abstenim? Nuk ka?
Miratohet rendi i ditës, pra: miratimi i mendimit zyrtar të Këshillit Bashkiak Maliq dhe përcjellja e tij pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të procesit të rishikimit të ndarjes administrativo-territoriale, ku Bashkia Maliq, siç thashë, është e prekur në këtë projekt. Kush e do fjalën? Nga grupet... grupi i opozitës?

Yllson Ibrahimllari:Të nderuar qytetarë të Bashkisë Maliq, të nderuar kolegë anëtarë të Këshillit Bashkiak, të nderuar përfaqësues të subjekteve politike që ushtrojnë aktivitetin në njësinë territoriale të Bashkisë Maliq, të nderuar deputetë. Kemi thirrur, duke respektuar rregulloren dhe ligjin, me 1/3-në e firmës së anëtarëve të këtij këshilli këtë mbledhje jashtë radhe për të diskutuar, për të diskutuar ndarjen e re, projektin mbi ndarjen e re territoriale të propozuar, që Bashkia e Maliqit, si njësi e administrimit vendor, do t'i bashkangjitet Bashkisë së Korçës. Bashkarisht, ju kemi dërguar, konform rregullores, një projektvendim i cili është firmosur nga një përfaqësi e anëtarëve të... që i përkasin grupit të opozitës, që në fakt kot na drejtoheni si opozitë, sepse në fakt sot në opozitë, në opozitë është i gjithë Këshilli Bashkiak, për arsye sepse janë... kemi bërë në mbledhjen e kryesisë dëgjesat, kemi vendosur të dalim me dëgjesat dhe kemi nevojë të dimë cili është rezultati i dëgjesave që janë ushtruar në njësitë e administrimit vendor, të cilat kanë sjellë një produkt në nivelin që do të na prezantohet, që është në nivelin 95-97%. Të gjitha qëndrimet e tjera jashtë këtij vullneti popullor, tashmë të shprehur dhe të dokumentuar, na bëjnë që ne të jemi në opozitë me atë çka përfaqësojmë. Pra, nuk jemi më në ndarjen e re elektorale të 2023-it, ku grupi jonë i përkiste opozitës, por sot mendimi qytetar është me mazhorancë dhe është shprehur kundra kësaj reforme në dëgjesat publike. Këshilltarët e dokumentojnë këtë gjë, kanë qenë pjesëmarrës, kanë ngritur zërin, dhe ne sot jemi përballë një gjëje që kemi sjellë një projektvendim që do të bëjmë legjitime ato çka janë përfituar nga dëgjesat publike. Ne jemi përfaqësues vendorë të komunitetit dhe mbrojmë interesat e veta. Çdo vendim tjetër i marrë nga ky këshill, konform të gjitha akteve ligjore, do të ishte në kundërshtim dhe në opozitë me mendimin qytetar dhe me verdiktin e komunitetit. Ju faleminderit.

Ornildi Demollari: Faleminderit.Nga grupi i mazhorancës?

Petrit Kupe: Përshëndetje. Të nderuar këshilltarë, sot jemi mbledhur për një takim të jashtë radhe për të diskutuar një problem që ka të bëjë me reformën administrative dhe territoriale. Me iniciativën e grupit të opozitës, kryesia vendosi që të organizohen dëgjesat në të gjitha njësitë administrative. Ne e përshëndetim këtë iniciativë dhe e vlerësojmë si një shqetësim real të opozitës, por edhe shqetësim real tonin. Ne morëm pjesë në të gjithë njësitë administrative, ku përgjithësisht u shpreh vullneti i lirë i qytetarëve, megjithëse jo një pjesëmarrje fort e kënaqshme, dhe evidentuam problemet që ata ngritën, shqetësimet që ata ngritën në qoftë se do të kryhet bashkimi i Maliqit me qytetin e Korçës. Disa nga shqetësimet që komuniteti ngriti në

këto takime kanë të bëjnë me pasigurinë e shërbimeve ndaj qytetarëve, si dhe aksesit të tyre për marrjen e shërbimeve, a do të përmirësohet në mënyrë të besueshme. Ka të bëjë me përqindjen e investimeve në momentin që mund të bëhet ky bashkim, në raport me popullsinë, territorin, e të tjera. Ky bashkim, përgjithësisht, e ka efektet edhe negative, veçanërisht për qytetin e Maliqit, i cili do ta ndjejë më shumë në qoftë se do të kryhet. Ne, si traditë në këtë bashki, është krijuar që qytetari të sigurojë kontaktin me jo vetëm me përfaqësuesit e njësive administrative, por edhe me kryetarin e bashkisë. Edhe ky është një merak që ekziston në komunitet. Por ne jemi të paqartë me këtë projekt, me këtë projektreformë. Ajo është një projekt i shkurtër që ne kërkojmë që të kemi sqarime të mëtejshme, sepse nuk e dimë si do të jetë ky qytet, me çfarë kompetencash do të jetë ky qytet, do të jetë si njësi administrative e nesërme, apo do të jetë një qytet që të mund të menaxhojë këto njësi administrative. Nuk e dimë me ligj si do të ndahen investimet, shpenzimet, investimet, fondet për investime apo fondet për shërbime, në krahasim me numrin e popullsisë, në krahasim me shtrirjen territoriale. Pra, janë disa çështje që ne në grupin tonë të këshilltarëve i diskutuam dhe mendojmë që është e arsyeshme të shprehemi për këtë mendim që ka ngritur opozita. Ne do të vazhdojmë të ngulim këmbë, të kemi sqarime të mëtejshme, për të dhënë mendimin tonë, sepse edhe kohë kemi, janë 60 ditë që ne. Edhe nuk kemi pse shprehemi kaq shpejt, pa u pjekur, pa u sqaruar me këtë projektvendim. Ky është mendimi i mazhorancës. Faleminderit.

Ornildi Demollari: Mirë, atëherë, në këto kushte, mendoj se ne nuk kemi, nuk jemi gati të shprehemi në lidhje me këtë, me këtë material që i është drejtuar këshillit, kështu që mendoj se mbledhjen mund ta mbyllim këtu dhe.

Mbajtës Protokolli

SEKRETARI I KËSHILLIT

Gertjan GJIRITI

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI